



PRIORITETET KRYESORE NË FUSHËN E ÇËSHTJEVE TË BRENDSHME PËR VITIN 2025

1. RRRITJA E SIGURISË PUBLIKE NËPËRMJET TEKNOLOGJISË “SMART CITY”.

- 1-1 Modernizimi i infrastrukturës teknologjike të Policisë së Shtetit për të mundësuar monitorim të avancuar dhe reagim më efikas.
- 1-2 Ulja e numrit të veprave penale përmes përdorimit të teknologjisë moderne në hetim dhe patrullim.
- 1-3 Përmirësimi i monitorimit të qarkullimit rrugor dhe kontrollit të territorit për të garantuar rendin dhe sigurinë në komunitet.

2 IMPLEMENTIMI I LIGJIT TË RI TË POLICISË SË SHETIT PËR PËRMIRËSIMIN E STRUKTURËS DHE EFIKASITETIT TË SHËRBIMIT POLICOR.

- 2-1 Përfundimi dhe miratimi i akteve nënligjore që përcaktojnë mënyrën e rregullimit të veprimtarisë së Policisë së Shtetit.
- 2-2 Ristrukturimi i shërbimit policor sipas parimeve të ligjit të ri për të rritur efikasitetin në punë.
- 2-3 Përmirësimi i funksionimit të Policisë së Shtetit përmes rregullimeve ligjore dhe nënligjore që mbështesin operacionet policore.

3 NGRITJA DHE FUNKSIONIMI I ZYRËS SË RIKUPERIMIT TË ASETVE KRIMINALE PËR FORCIMIN E LUFTËS KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR, KORRUPSIONIT DHE PASTRIMIT TË PARAVE.

- 3-1 Forcimi i bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar në identifikimin dhe gjurmimin e aseteve kriminale.
- 3-2 Ngritja e kapaciteteve të Zyrës për të zbatuar strategjitë e rikuperimit të pasurive të paligjshme.
- 3-3 Angazhimi në ndjekjen ligjore dhe konfiskimin e aseteve që lidhen me krimin e organizuar dhe korrupsionin.

4 GARANTIMI I MBARËVAJTJES SË PROCESIT ZGJEDHOR PËR TË SIGURUAR TRANSPARENÇË, DREJTËSI DHE BESUESHMËRI NË ZGJEDHJE.

- 4-1 Organizimi dhe koordinimi i të gjitha fazave të procesit zgjedhor në përputhje me ligjin dhe standardet ndërkombëtare.
- 4-2 Sigurimi i infrastrukturës dhe burimeve teknike për mbështetjen e procesit zgjedhor.
- 4-3 Trajnimi i stafit dhe monitorimi i procesit për të parandaluar parregullsitë dhe garantuar integritetin e zgjedhjeve.

5 SIGURIMI I SAKTËSISË DHE PËRDITËSIMIT TË LISTËS ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE 2025, PËR VOTUESIT BRENDA DHE JASHTË VENDIT, SI DHE PËRMIRËSIMI I SISTEMIT TË NJOFTIMIT TË VOTUESVE.

- 5-1 Prodhimi listës së plotë dhe të përditësuar të votuesve brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.
- 5-2 Përditësimi i të dhënave në sistemin e gjendjes civile dhe në platformën e-Albania për njoftimin dhe identifikimin e votuesve në mënyrë të saktë dhe efektive.
- 5-3 Sigurimi i informacionit të qendrës së votimit për çdo votues në mënyrë të saktë dhe në kohë.

6 ZHVILLIMI DHE IMPLEMENTIMI I IDENTITETIT DIGJITAL PËR SHTETASIT SHQIPTARË PËR TË MUNDËSUAR AKSES TË SIGURT DHE EFIKAS NË SHËRBIMET PUBLIKE DHE PRIVATE NË RRUGË ELEKTRONIKE.

- 6-1 Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore që do të mundësojnë implementimin teknike të identitetit digjital.
- 6-2 Sigurimi i përdorimit të identitetit digjital për akses të thjeshtë dhe të sigurt në çdo shërbim publik dhe privat online.
- 6-3 Ndërtimi i infrastrukturës teknologjike që mbështet përdorimin e gjerë të identitetit digjital në shërbime elektronike.

7 NJOHJA NDËRKOMBËTARE E PASAPORTËS BIOMETRIKE SHQIPTARE DHE INTEGRIMI I SHQIPËRISË NË DREJTORINË E CELËSAVE PUBLIKË (PKD) TË ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË AVIACIONIT CIVIL (ICAO).

- 7-1 Aplikimi dhe regjistrimi i Shqipërisë në ICAO PKD për të mundësuar shkëmbimin periodik dhe të sigurt të të dhënave biometrike.
- 7-2 Kryerja e shkëmbimit të të dhënave me PKD për të rritur sigurinë dhe vlefshmërinë ndërkombëtare të pasaportës biometrike shqiptare.
- 7-3 Anëtarësimi zyrtar i Shqipërisë në ICAO PKD dhe përmbushja e standardeve ndërkombëtare të aviacionit civil dhe sigurisë kufitare.

8. PËRMIRËSIMI I MENAXHIMIT TË KUFIRIT DHE MIGRACIONIT NË PËRPUTHJE ME KËRKESAT E BASHKIMIT EVROPIAN DHE OBJEKTIVAT E INTEGRIMIT EVROPIAN.

- 8-1 Rishikimi i ligjit “Për kontrollin kufitar” me fokus në listën e pasagjerëve dhe procedurat për menaxhim më të mirë.
- 8-2 Nisja e procedurave për ngritjen e Qendrës së Menaxhimit të Integruar të Kufirit për të përmirësuar kontrollin dhe bashkëpunimin ndërinstytucional.
- 8-3 Hartimi i projektligjit “*Për mbledhjen, përpunimin, transmetimin, ruajtjen, fshirjen, mbrojtjen dhe garantimin e të dhënave të informacionit të pasagjerit*” për të siguruar mbrojtjen e të dhënave personale dhe përputhshmërinë me standardet evropiane.

9. PARANDALIMI I EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM (CVE) PËRMES FUQIZIMIT TË KAPACITETEVE MONITORUESE DHE BASHKËPUNIMIT RAJONAL.

- 9-1 Fuqizimi i kapaciteteve identifikuese dhe monitoruese në fushën e ekstremizmit të dhunshëm dhe financimit të terrorizmit.
- 9-2 Përforcimi i bashkëpunimit me Komitetet Rajonale Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm për koordinim më efektiv të veprimeve.
- 9-3 Zbatimi i proceseve të RRR (Refuzim, Rishikim, Riintegrim) për menaxhimin e rasteve të ekstremizmit të dhunshëm.

10. FORCIMI I SHËRBIMIT PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN PËRMES PËRDITËSIMIT TË KUADRIT LIGJOR DHE PËRMIRËSIMIT TË KUSHTEVE TË PUNËS.

- 10-1 Hartimi i projektvendimeve në zbatim të ligjit nr. 152/2015 *“Për përmirësimin e funksionimit të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit”*.
- 10-2 Përgatitja e projekt-VKM-së *“Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 350, datë 19.04.2017, i ndryshuar me Vendimin nr. 624, datë 25.09.2022, Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të këtij shërbimi”*.
- 10-3 Përmirësimi i kushteve ekonomike dhe motivimi i punonjësve të Shërbimit për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin për të rritur efikasitetin dhe përgjegjshmërinë në kryerjen e detyrave.

11. FORCIMI I MBROJTJES SË TERRITORIT PËRMES LUFTËS KUNDËR INFORMALITETIT DHE MONITORIMIT TË ZONAVE TË RËNDËSISHME NATYRORE DHE INFRASTRUKTURE.

- 11-1 Lufta kundër informalitetit në zonat bregdetare dhe zonat e mbrojtura për të ruajtur integritetin e territorit.
- 11-2 Inspektimi dhe monitorimi i rrugëve kombëtare dhe projekteve me interes publik për sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm.
- 11-3 Monitorimi i pyjeve, burimeve ujore dhe lumenjve për mbrojtjen e resurseve natyrore dhe ekosistemeve.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E BRENDSHME